

# Einführung (Hinweise zur Benutzung des Begleitbuches)

## Hyrje (Udhëzime për përdorimin e librit shoqërues)

Përpara ju sh ndodhet libri i parë shoqërues i kursit të gjermanishtes në radio **“Deutsch–warum nicht?”**. Ky libër do të jetë miku juaj, për t’u këshilluar për emisionin apo për të thelluar dijet tuaja, pra për t’ju ndihmuar kur të keni nevojë. Por ky libër sigurisht nuk mund të zëvendësojë kursin e gjubës në radio. Këshilla jonë do të ishte që mësimet t’i dëgjoni fillimisht në radio. Për këtë qëllim, çdo mësim përmban ushtrime dëgjimi, të cilave ju mund t’u përgjigjeni gjatë emisionit. Këto ushtrime, të cilat kanë të bëjnë me të kuptuarit synojnë që t’ju ndihmojnë të kapni që me dëgjimin e parë se përse bëhet fjalë në një mësim: cila është situata, mjedisi ku zhvillohet ngjarja, kush flet, përse po flet ai person, cila është atmosfera etj. Me një fjalë: ju duhet të përpiqeni të kuptoni situatën e përgjithshme dhe të mos mundoheni të kuptoni çdo fjalë.

Ekzistojnë disa teknika (metoda) dëgjimi, të cilat ua lehtësojnë të kuptuarit e një gjubë të huaj. Me këto teknika ju do të njiheni gjatë tri emisioneve të para. Pra, kursi radiofonik nuk fillon menjëherë me thelbin e temës që trajtohet.

Dëgjoni, pra, në fillim mësimet në radio dhe njëkohësisht përpiquni të gjeni se përse mund të jetë fjala. Kjo do t’jua bëjë më të afërt dhe më interesant kursin dhe do të ndikojë që ju ta mbani mend më mirë atë që sapo dëgjuat, pasi kështu keni marrë pjesë aktivisht në të.

Ky libër shoqërues përmban këto çështje:

### A Të dbëna për mësimet e ndryshme (= faqe 13–106)

1. Një përmbledhje  
Kjo përmbledhje përmban çështjet kryesore të gramatikës, si edhe shprehjet më të rëndësishme që përdoren në mësim. Çështjet gramatikore pastaj zgjerohen dhe zëbërthehen.
2. Dialogë të mësimëve të ndryshme  
Teksti i këtyre dialogëve është dbënë vetëm në gjermanisht. Por këtu janë futur disa shpjegime në gjubën shqipe mbi zhvillimin e veprimit. Po që se rastësisht ju nuk keni mundur ta dëgjoni mësimin, mund ta ndiqni kursin duke e lexuar mësimin në libër.
3. Fjalë dhe shprehje  
**“Wörter und Wendungen”** – fjalë dhe shprehje në gjermanisht dhe në shqip. Lista e tyre ndodhet nën tekstin e dialogëve. Fjalët dhe shprehjet e dbëna në mësimin e mëparshëm nuk përsëriten në këtë rubrikë të mësimt pasardhës. Po që nevoja ju, megjithatë, mund t’i gjeni ato në fjalorin alfabetik (shih D). Atje shënohet mësimi ku janë shfaqur për herë të parë këto fjalë.

#### 4. Ushtrime

*Shumica e ushtrimeve janë ushtrime gramatikore. Zhvillojini ushtrimet me shkrim. Zgjidhjen e tyre mund ta gjeni nën kreun C. Disa ushtrime kanë më shumë se një zgjidhje: kjo është shënuar në shtojcën “çelësi i ushtrimeve”.*

*Pas kësaj përmbledhjeje për të 26 mësimet, libri përmban edhe shtojcat e mëposhtme:*

#### **B Përmbledhje e gramatikës** (faqe 109– 118)

*Kjo është një përmbledhje në formë tabelash e çështjeve të gramatikës të shtjelluara gjatë mësimëve.*

#### **C Çelësi i ushtrimeve** (faqe 119– 126)

*Këtu ju mund të kontrolloni vetë nëse i keni zgjidhur drejt ushtrimet e çdo mësimi.*

#### **D Fjalori alfabetik** (faqe 127–137)

*Këtu përfshihen të gjitha fjalët që janë përdorur në pjesën e parë të këtij kursi, në gjermanisht dhe në shqip. Shifra pas fjalës tregon mësimin ku është përdorur për herë të parë fjala.*

#### **E Përktimi i dialogëve** (faqe 138– 160)

*Këto ushtrime synojnë të ndihmojnë për të kuptuar përmbajtjen. Nuk këshillohet krabasimi i drejtpërdrejtë me tekstin në gjermanisht, kur doni të kuptoni vetëm një fjalë ose vetëm një strukturë gramatikore.*

*Dhe tani, për ta mbyllur këtë hyrje, edhe diçka tjetër: siç mund ta merrni me mend, ky kurs i gjermanishtes është destinuar për t'u transmetuar në të gjithë botën, në një numër shumë të madh gjuhësh. Për këtë arsye nuk ka qenë e mundur të merren parasysh veçoritë specifike të vendit tuaj, të kulturës dhe të gjuhës suaj. Qëllimi i këtij kursi është që ju të ambientoheni me realitetin dhe jetën e përditshme në Gjermani, me mentalitetin gjerman dhe diçka me poezinë, të gjitha këto natyrisht në gjermanisht. Për këtë ne kemi futur këtu një personazh imagjinar që na shoqëron gjatë mësimëve, një personazh që është me rëndësi në përrallat dhe legjendat popullore ku flitet për shpirta dhe qenie mitologjike, si vitore, kukudhe, zana etj. Mos u habitni që gjeni një personazh të tillë edhe në një kurs gjuhe. Në fund të fundit, gjuba përmban shumë elemente të fantazisë. Nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'ju urojmë suksese në zotërimin e këtij kursi dhe ... zbatimje!*

Herrad Meese

*P.S.: Edhe nëse nuk e përdorni rregullisht këtë libër shoqërues, do të ishte mirë që ju të lexoni udhëzimet dhe këshillat që jepen në tri mësimet e para. Aty do të gjeni edhe udhëzime të përgjithshme për zhvillimin e kursit. Po të doni të dini më tepër për personazhin fantastik, lexoni të dbënat që jepen për të në mësimin 8.*

# Einige Informationen

## *Disa të dhëna*

**I** Harta gjeografike e vendeve gjermanishtfolëse



## 2 Shkronjat e alfabetit

A	Abend	N	Namen	Veçori
a	aber	n	nach	ä Käse
B	Bad	O	Orangensaft	ö unhöflich
b	bald	o	oder	ü für
C	Café	P	Portier	au glauben
c	chic	p	probieren	äu Verkäufer
D	Diplomat	Q	(Quittung)	ai (Mai)
d	da	q	(quer)	ei Bein
E	Entschuldigung	R	Reportage	eu Leute
e	er	r	rauchen	ou Journalistik
F	Flasche	S	Sachen	Ch Chef
f	fahren	s	sagen	ch chaotisch
G	Geld	T	Taxi	ch nicht
g	genau	t	teuer	Sch Schachtel
H	Herr	U	Uhr	sch schlecht
h	heißen	u	unhöflich	St Stimme
I	Idee	V	Vater	st stimmt
i	ich	v	verheiratet	ß heißen
J	Journalistik	W	Wohnort	
j	ja	w	wann	
K	Käse	X	(Xanten)	
k	kommen	x	Taxi	
L	Lied	Y	(Yoga)	
l	lange	y	typisch	
M	Mark	Z	Zimmer	
m	machen	z	zeigen	

## 3 Numrat

1 = eins	15 = fünfzehn	1000 = tausend
2 = zwei	16 = sechzehn	31 = einunddreißig
3 = drei	17 = siebzehn	42 = zweiundvierzig
4 = vier	18 = achtzehn	53 = dreiundfünfzig
5 = fünf	19 = neunzehn	64 = vierundsechzig
6 = sechs	20 = zwanzig	75 = fünfundsiebzig
7 = sieben	30 = dreißig	86 = sechsundachtzig
8 = acht	40 = vierzig	97 = siebenundneunzig
9 = neun	50 = fünfzig	200 = zweihundert
10 = zehn	60 = sechzig	201 = zweihunderteins
11 = elf	70 = siebzig	210 = zweihundertzehn
12 = zwölf	80 = achtzig	10.000 = zehntausend
13 = dreizehn	90 = neunzig	100.000 = hunderttausend
14 = vierzehn	100 = hundert	1.000.000 = eine Million

#### 4 Monedhat

Njësia monetare bazë e Gjermanisë quhet markë, më saktë **Deutsche Mark**. Një markë është e barabartë me 100 pfenigë.

Njësitë monetare bazë të vendeve gjermanishtfolëse (Gjermani, Austri, Zvicër) janë të ndryshme nga një vend në tjetrin.

Monedhat e markës kanë këto vlera:



Ein Pfennig  
një pfenig



zwei Pfennig  
dy pfenigë



fünf Pfennig  
pesë pfenigë



zehn Pfennig  
dhjetë pfenigë



fünzig Pfennig  
pesëdhjetë pfenigë



eine Mark  
një markë



zwei Mark  
dy marka



fünf Mark  
pesë marka

Vlerat e kartëmonedhave të markës janë këto:



*Njësia monetare bazë e **Zvicrës** quhet frang, më saktë: **Schweizer Franken**. Një frang zviceran është i barabartë me 100 rapen.*



*Njësia monetare bazë e **Austrisë** quhet shilingë, më saktë: **Österreichischer Schilling**. Një shilingë është e barabartë me 100 groshë.*

